

### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për vitin 2020
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Titujve të Qeverisë për vitin 2020
- Tregtimi i Titujve në Bursën ALSE për vitin 2020

### Publikime Profesionale

BIS	Monedhat dixhitale dhe e ardhmja e sistemit monetar
Global Risk Regulator	Rregullimi global në 2021: reagim, reflektim dhe kthim te përparësitë
IOSCO	IOSCO i përgjigjet konsultimit të IFRS mbi Raportimin e Qëndrueshmërisë

### Informacione Ndërkombëtare

- Hungari
- Kroaci
- Maqedonia e Veriut
- Poloni
- Qipro
- Rumani
- Sllovaki

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

# VËSHTRIM MBI TREGJET


## Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, 2020

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit në vitin 2020 arritën vlerën 16,608 milionë lekë, ose 5.73% më pak se gjatë vitit 2019. Gjatë vitit 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 965,447 me një ulje prej 29.16% krahasuar me vitin 2019.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.93% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me 7.02%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.18% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.82% të totalit të tregut.

Gjatë vitit 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 7,560 milionë lekë, ose 18.55% më shumë se gjatë vitit 2019.

Struktura e tregut të sigurimeve, viti 2020




Gjatë viti 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 7,560 milionë lekë, ose 18.55% më shumë se gjatë vitit 2019.

## Zhvillimet e tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për vitin 2020

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2020, u dominua në masën 63.21% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 36.79% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 87.21% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për vitin 2020, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 43.77% dhe 41.32% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për vitin 2020 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.26% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.



Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për vitin 2020 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.26% të të gjitha transaksioneve në treg.

### Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2020, ka pasur një ulje prej 2,749 milionë lekë ose 48.86% krahasuar me vitin 2019. Numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 19.30%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë vitit 2020, ka pasur një rritje prej 201 milionë lekë ose 7.95%, ndërkohë pati një ulje në numrin e transaksioneve në masën 28.96%, krahasuar me vitin 2019.

Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një ulje në vlerë absolute me rreth 2,548 milionë lekë, krahasuar me vitin 2019.

## Tregtimi i Titujve në Bursën ALSE për vitin 2020

(Sipas <https://alse.al/>)

Sipas të dhënave statistikore të Bursës ALSE gjatë vitit 2020 në këtë bursë janë tregtuar Bono Thesari në vlerën 183,454,853 lekë dhe Obligacione Thesari në vlerën prej 1,415,381,327 lekë. Duke analizuar volumin për njësi të tregtuara, numrin e transaksioneve dhe vlerën e tregtuar, gjatë këtij viti, kanë dominuar transaksionet *off – exchange*.

Gjatë 2020 ka patur një ulje të ndjeshme të vlerës së transaksioneve të kryera. Në analizën tonë janë disa faktorë që kanë ndikuar në këtë rënie të vlerës së tregtimeve si:

- Rënia e normave të interesit në Titujt Qeveritarë gjatë vitit 2020;
- Rënia e tregtimeve nga personat juridikë (fondet) për arsye se duke rënë normat e interesit nuk kanë qenë aktiv për riformatimin e portofolit të tyre;
- Situata e pandemisë COVID-19 në tregjet financiare të vendit;
- Rënia e besueshmërisë së investitorëve tek një ecuri e qëndrueshme e tregjeve financiare afatshkurtër

Nga të dhënat e tregtimit në ALSE, për vitin 2020, sipas llojit të transaksioneve, kanë dominuar në volum, vlerë dhe numër, transaksionet e ekzekutuara për llogari të klientëve.

Gjatë viti 2020, në Bursën ALSE kanë dominuar transaksionet *off – exchange*.

Tregtimi i Titujve të Qeverisë të R. Sh. në Bursën ALSE		
Lloji i Transaksionit	Vlera e Tregtimit (në Lekë)	
	Bono Thesari	Obligacione Thesari
për Anëtarët:	4,481,620	4,413,410
për Klientët:	178,973,233	1,410,967,917
Individë:	49,698,233	346,559,687
Persona Juridikë:	129,275,000	1,064,408,230
<b>TOTAL</b>	<b>183,454,853</b>	<b>1,415,381,327</b>

The screenshot shows the BIS website interface. At the top, there is a search bar and navigation links for 'About BIS', 'Research & publications', 'Committees & associations', 'Central bank hub', 'Statistics', 'Banking services', and 'Media & speeches'. The main content area features a sidebar with 'Media & speeches' selected, and a main article titled 'Digital currencies and the future of the monetary system' by Agustín Carstens, dated 27 January 2021. The article text discusses the challenges of digital currencies, such as access based on verification of identity or cryptography, and the role of central banks in issuing and managing digital currencies (CBDCs).

## Monedhat dixhitale dhe e ardhmja e sistemit monetar [www.bis.org](http://www.bis.org)

Agustín Carstens

Revolucioni teknologjik po ndryshon ekonominë tonë, madje edhe vetë paranë. Përveç përmirësimeve që janë bërë në sistemet ekzistuese të pagesave, kanë hyrë në tregje edhe monedhat e reja dixhitale. Megjithatë shoqëritë përballen me dy drejtime në rrugën për përdorimin e parësë dixhitale.

Së pari, a duhet që monedhat dixhitale të kenë mbështetjen e një autoriteti qendror apo nevojitet një sistem i decentralizuar i qeverisjes së tyre? Së dyti, a duhet që aksesit të bazohet në verifikimin e identitetit, apo thjesht në kriptografi?

Përgjigja është se nëse monedhat dixhitale janë të nevojshme, bankat qendrore duhet të jenë emetuesit dhe ata duhet të japin akses bazuar në identifikimin.

Monedhat dixhitale të bankës qendrore (*Central Bank Digital Currencies, CBDC*) mund të ndërthurin teknologji të reja dixhitale me principin themelor, tashme të provuar dhe të besuar të bankave qendrore.

Zhvillimi i CBDC do të jetë i lidhur me një mori çështjesh teknologjike, ligjore dhe ekonomike që garantojnë ekzaminim të kujdesshëm para prezantimit dhe përdorimit të tyre në treg. Bankat qendrore - rojet e stabilitetit - do të veprojnë me kujdes, në mënyrë metodike dhe në përputhje me mandatet e tyre.

BIS po mbështet këtë diskutim ndërkombëtar, duke siguruar që bankat qendrore mund të vazhdojnë të mësojnë nga njëra-tjetra dhe të mund të bashkëpunojnë për çështje kyçe të dizajnit.

# Global regulation in 2021: reaction, reflection and a return to priorities

Molly Preleski | January 11, 2021



The year 2020 defied expectations and saw disruption to both financial markets and regulatory agendas. As the world recovers, 2021 is shaping up to be defined by continued regulatory reactions to the Covid-19 pandemic, and geopolitical changes such as the UK's exit from the EU. By Molly Preleski, financial services expert at PA Consulting

## Rregullimi global në 2021: reagim, reflektim dhe kthim te përparësitë

[www.globalriskregulator.com](http://www.globalriskregulator.com)

Molly Preleski

Viti 2020 sfidoi pritshmërinë dhe tregoi disa shqetësime si në tregjet financiare ashtu edhe në agjendat e rregullatorëve. Ndërkohë që bota po fillon të rimëkëmbet, viti 2021 po formësohet nga reagimet e vazhdueshme rregullatore ndaj pandemisë Covid-19, si edhe ndryshimet gjeopolitike siç është dalja e Mbretërisë së Bashkuar nga BE.

Rregullatorët në të gjithë botën, por veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar, do të reflektojnë mbi efektivitetin e regjimeve të ndryshme pas krizës që janë testuar nga Covid-19.

Më së fundi, ndërsa bota ngadalë po i kthehet normalitetit gjatë 2021, rregullatorët e kanë bërë të qartë se ata do të kthehen në përparësitë që ishin lënë mënjanë. Kjo do të thotë se ky do të jetë një vit tjetër, tejet i ngarkuar për firmat e shërbimeve financiare.

...

*Artikulli përshkruan disa nga sfidat dhe rreziqet me të cilat ndeshen rregullatorët e tregjeve financiare gjatë vitit 2021 si edhe prioritetet e tyre, si:*

*Rreziku operacional*

*Rreziku i klimës*

*Iniciativat kryesore*

*Krimi financiar*

*Mbretëria e Bashkuar – post Brexit*



## IOSCO i përgjigjet Konsultimit të IFRS mbi Raportimin e Qëndrueshmërisë \*

<https://www.iosco.org/>

IOSCO mbështet krijimin e një Bordi të Standardeve të Qëndrueshmërisë (SSB) nën Fondacionin e IFRS, i cili do t'i nënshtrohet shqyrtimit të "Bordit të Trustees". Bordi i Standardeve të Qëndrueshmërisë do të përcaktojë se si janë plotësuar "kërkesat për sukses" të përkrahura në dokumentin e konsultimit.

Rregullatorët e letrave me vlerë dhe autoritetet e tjera të tregut të kapitalit janë përgjegjës për mbikëqyrjen e tregjeve. Në këtë sfond, IOSCO ka një vend të veçantë për të ndihmuar Fondacionin IFRS në formimin e rolit të saj në të ardhmen në raportimin e korporatave mbi qëndrueshmërinë. IOSCO ka një histori të gjatë bashkëpunimi me Fondacionin IFRS dhe ka mbështetur prej kohësh këtë Fondacion për përputhjen e objektivave të përbashkët të promovimit dhe lehtësimit të transparencës brenda tregjeve të kapitalit. Në vitin 2000, IOSCO nxori një Rezolutë që vendosi bazat për miratimin e standardeve të IFRS-ve nga të gjithë anëtarët e saj. Sot, 144 juridiksione anëtare të IOSCO-s përdorin IFRS-të. Në vitin 2009, IOSCO bashkëpunoi me Bordin e Besimit të IFRS për të krijuar një Bord Monitorimi të autoriteteve publike, të cilin IOSCO e kryeson.

IOSCO beson se standarde të forta të Raportimit të Qëndrueshmërisë, të ndërlidhura me standardet e raportimit financiar, do të mbështesnin auditimin dhe sigurinë - duke rritur besimin e tregut në zbulimin e qëndrueshmërisë dhe duke vendosur bazat e raportimit të detyrueshëm nga korporatat mbi qëndrueshmërinë ndërkombëtare. IOSCO sheh një nevojë urgjente për të përmirësuar tërësinë, qëndrueshmërinë dhe krahasueshmërinë e Raportimit të Qëndrueshmërisë. Së bashku, konsultimi i Fondacionit IFRS dhe një iniciativë paralele bashkëpunuese e një aleance të organizatave të Raportimit të Qëndrueshmërisë mund të çojë më tej përpjekjet për të lehtësuar standarde të krahasueshme me cilësi të lartë ndërkombëtare që sigurojnë përmbajtjen që u duhet tregjeve të kapitalit.

IOSCO është e përkushtuar të ndihmojë përparimin e këtyre iniciativave me qëllim krijimin e një sistemi global gjithëpërfshirës të raportimit të korporatave.

*\* (Sustainability Reporting - Raportimi i Qëndrueshmërisë u mundëson organizatave të marrin në konsideratë ndikimet e tyre në një gamë të gjerë të çështjeve të qëndrueshmërisë. Kjo u mundëson atyre që të jenë më transparente në lidhje me rreziqet dhe mundësitë me të cilat përballen.*

## HUNGARI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave tremujore të Bankës Qendrore të Hungarisë, në fund të shtatorit 2020 vëllimi i primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve arriti në 897.62 miliardë HUF ose rreth 2.5 miliardë EUR, duke shënuar një rritje me 4.11% në terma vjetorë. Kjo pasqyroi një rritje prej 2.42% në sigurimin e Jetës dhe 5.39% në sigurimet e Jo-Jetës. Tregu i sigurimeve të Jetës përbën 42.40% dhe sigurimet e Jo-jetës 57.60% të vëllimit të primeve të shkruara bruto në total.

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2020, numri i përgjithshëm i kontratave të kompanive të sigurimeve u rrit me gati 1% nga ai i një viti më parë dhe tejkaloi shifrën e 14.41 milionë kontrata, duke reflektuar më shumë se 193,000 kontrata të reja. Kjo kryesisht rezultoi nga një rritje prej 1.4% e numrit të kontratave të sigurimeve të Jo-Jetës, ndërsa kontratat e sigurimit të Jetës pësuan rënie prej 1.5%.

Në fund të Shtatorit 2020, në tregun hungarez të sigurimeve ishin aktiv 22 sigurues: 5 sigurues të specializuar të Jetës, 9 Jo-Jetës dhe 8 sigurues me aktivitet si në sigurimin e Jetës dhe të Jo-Jetës.



## KROACI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas informacioneve te publikuara nga *The Croatia News*, Dhoma Kroate e Tregtisë (HGK) vlerëson se për vitin 2020, primet e sigurimit në lidhje me rrezikun e tërmetit do të arrijnë rreth 110 milionë HRK, që paraqet një rritje prej 28% më shumë se viti i kaluar. Kjo vlerësohet të jetë rezultat i tërmeteve që goditën vendin gjatë vitit 2020.

Në të njëjtën kohë, HGK vlerëson se numri i policave të sigurimit që mbulojnë tërmetin do të rritet duke arritur në fund të vitit 2020 deri në 140,000, me një rritje prej rreth 30% krahasuar me vitin 2019.

Sipas këtij portali të lajmeve që citon HGK "... tërmetet shkatërruese që goditën Kroacinë vitin e kaluar kanë shkaktuar dëme në vlerë prej mbi 100 miliardë HRK dhe shumë njerëz kanë humbur pronat e tyre, kështu që nuk është për t'u habitur që pas goditjes që tronditi Zagrebin dhe rrethinat e tij në mars, pati rritje në sigurimin nga tërmeti".

Vlen të përmendet se pas tërmetit të marsit 2020, siguruesit vendas paguanin rreth 237.5 milionë HRK dhe përpunuan 7,269 kërkesa për dëmshpërblime deri në fund të nëntorit. Primi mesatar i sigurimit nga tërmeti është 800 HRK.

Ndërkohë, sipas shifrave të publikuara nga Byroja Kroate e Sigurimeve, CIB, vëllimi I primeve të shkruara bruto për të 18 siguruesit aktivë kroatë, në fund të vitit 2020 ra me 0.66% krahasuar me vitin 2019, duke arritur në 10.47 miliardë HRK ose rreth 1.38 miliardë EUR.

Primet e shkruara bruto nga sigurimi i Jo-Jetës u rritën me 4.67% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 duke arritur në 7.82 miliardë HRK, ndërsa primet në sigurimet e Jetës u ulën me 13.68% në krahasim me vitin 2019, duke arritur në 2.64 miliardë HRK.

## MAQEDONIA E VERIUT

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të tregut të botuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, për periudhën 9-mujore të vitit 2020, siguruesit në vend realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 7.52 miliardë Denarë, rreth 122 milionë EUR, ose 5.22% më pak e njëjta periudhë e një viti më parë.

Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës dominuan tregun, duke zënë më shumë se 84% të vëllimit total të primeve, duke arritur në 6.33 miliardë Denarë, ose 102.7 milionë euro. Nga këto MTPL zinte 40.75% të totalit, sigurimi i pronës rreth 20.13%. Sigurimet e Jetës zinin rreth 16% të primeve të shkruara bruto.

## **POLONI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave tremujore të tregut të sigurimeve të botuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë (KNF), në fund të shtatorit 2020, tregu i sigurimeve në vend arriti në 46.5 miliardë PLN ose rreth 10.2 miliardë EUR. Kjo shifër shënon një rënie prej 1% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara nga siguresit lokalë u ulën me rreth 4%, duke arritur në 29.5 miliardë PLN, rreth 6.5 miliardë EUR.

Gjatë nëntëmujorit të vitit 2020, siguresit polakë realizuan rreth 5,2 miliardë PLN fitim neto ose 1.1 miliardë euro, që është një shifër 13% më e vogël se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Për të njëjtën periudhë kohore, siguresit paguan mbi 1.1 miliardë PLN, rreth 240 milionë EUR, si tatim mbi të ardhurat në Buxhetin e Shtetit. Depozitat në bono të brendshme dhe instrumente të tjerë të sigurt arritën në 85 miliardë PLN.

## **QIPRO**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të botuara nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros - IAC, tregu i sigurimeve në vend, në fund të tremujorit të tretë 2020 u rrit me 0.74% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në shumën 66,823 milion EUR.

Sigurimi i Jetës u rrit me 2.82% krahasuar me nëntëmujorin e 2019, duke arritur në 292.50 milionë EUR, ndërsa segmenti i sigurimit të Jo-Jetës raportoi një rënie prej 0.82%, duke arritur në 375.73 milionë EUR krahasuar me vitin 2019.

Tre klasat kryesore të sigurimit të Jo-Jetës – “sigurimi nga aksidentet dhe shëndeti”, “sigurimi nga zjarri” dhe “sigurimi motorik” - arritën në 330 milionë EUR – me vlerë sa 88% e primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës.

Në të njëjtën kohë, vlera e dëmeve të ndodhura (dëmshpërblime të paguara nga siguresit dhe dëmet e provigjonuara së bashku) u ul me 9.38% duke arritur në 330.67 milionë EUR.

## RUMANI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Rumanisë në shifrat e publikuara pasqyron se gjatë 9- mujorit të parë të vitit 2020, tregu i sigurimeve në Rumani arriti një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 8.52 miliardë RON, ose rreth 1.74 miliardë euro. Kjo shifër tregon një rritje prej afërsisht 4.77% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës arritën në 6.87 miliardë RON, duke u rritur me 6.34% krahasuar me nëntëmuajorin e 2019. Ndërsa Primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve të Jetës u ulën me 1.29% duke arritur në 1.64 miliardë RON.

Sigurimet e Jo-Jetës mbizotërohen nga sigurimet motorike, që përfaqësojnë afërsisht 71% të primeve të shkruara bruto të Jo-Jetës dhe rreth 57% të tregut të përgjithshëm.

Në fund të shtatorit 2020, në tregun rumun të sigurimeve ishin aktivë 28 sigures të autorizuar dhe të rregulluar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në vend, nga të cilët 15 sigures të Jo-Jetës, 7 sigures të Jetës dhe 6 sigures me aktivitet në të dy sektorët.

## SLLOVAKI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave financiare të botuara nga Banka Kombëtare e Sllovakisë, gjatë 9-mujorit 2020, tregu i sigurimeve i Republikës Sllovaqe arriti në 1.68 milionë EUR, ose rreth 1.88% më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Segmenti i sigurimit të Jetës ra me 6.82% duke arritur në 702.89 milionë EUR, që përbën rreth 41.79% të tregut të përgjithshëm të sigurimeve. Ndërsa 58.21% e mbetur e tregut të sigurimeve vjen nga klasat e Jo-Jetës, të cilat gjeneruan rreth 979.17 milionë EUR, ose 2% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2019.



---

---

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)